



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

---

**Njoftim për shtyp**  
(10 korrik 2015)

**Mbi prezantimin e *Peer Review* për zbatimin e Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës në Konferencën e 7-të të UNCTAD në Gjenevë**

Gjatë punimeve të Konferencës së 7-të të UNCTAD (United Nations Conference on Trade and Development) zhvilluar në Gjeneve në 06-10 korrik 2015, në datën 7 korrik 2015 u mbajt një sesion i veçantë për vlerësimin (Peer Review) e Politikës dhe Ligjit të Konkurrencës në Shqipëri, i cili ishte kërkuar në mënyrë vullnetare nga Autoriteti i Konkurrencës.

Në këtë proces UNCTAD angazhoi një grup ekspertësh të njohur të fushës, të cilët realizuan intervistat fakt-mbledhese me të gjithë përfaqësuesit e institucioneve që luajnë rol kyç në zbatimin e Ligjit dhe të Politikës së Konkurrencës në Shqipëri. Përkatësisht këto takime u realizuan me Kryetarin e Kuvendit të Shqipërisë, Z. Ilir Meta, Keshilltaren e Kryeministrit, Znj. Eralda Methasani, Zv/Ministren e MZHETST, Znj. Brunilda Paskali, si dhe përfaqësuesit e komunitetit të biznesit dhe konsumatorëve, entet rregullatore.

Raporti i përgatitur u prezantua dhe drejtuesit e sesionit vlerësuan maksimalisht zhvillimet e ligjit dhe politikës së konkurrencës në Shqipëri, rastet hetimore dhe pavarësinë në vendimarrje të Komisionit të Konkurrencës, përafrimin e legjislacionin, advokatinë dhe kulturën e konkurrencës etj.

Në fjalën e saj Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës, Znj. Lindita Milo (Lati) u shpreh se Autoriteti i Konkurrencës megjithëse në një histori relativisht të shkurtër të veprimtarisë rreth 11 vjeçare, ka luajtur një rol të rëndësishëm për mbrojtjen dhe promovimin e konkurrencës në Shqipëri, duke bashkëpunuar ngushtë me entet rregullatore, institucionet publike dhe Komisionin Europian.

Në konkluzionet e raportit theksohet ndër të tjera se legjislacioni aktual mundëson zbatimin e një politike efektive të konkurrencës në gjithë sektorët e ekonomisë dhe se Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës ka shënuar progres të vazhdueshëm në rritjen e kulturës së konkurrencës ndërmjet biznesit dhe konsumatorëve si dhe ka dhënë rekomandimet e nevojshme për politikbërësit për aktet që mund të kenë prekur funksionimin e konkurrencës në treg.

Raporti vlerëson se përfshirja e Autoritetit të Konkurrencës në reformën rregullatore dhe zbatimin e advokatisë së konkurrencës nëpërmjet rekomandimeve për entet rregullatore, padyshim që ka patur efekte në mirëfunksionimin e tregjeve të rregulluara.

Sipas ekspertëve të UNCTAD lufta ndaj karteleve përveç punës profesionale të Autoritetit të Konkurrencës kërkon një politikë lehtësimi dhe rritje të bashkëpunimit me institucionet e tjera publike, në mënyrë të veçantë për marrëveshjet e ndaluara në prokurimet publike.

Raporti konkludon me disa rekomandime si (i) përafrimi i plotë i politikës kombëtare të konkurrencës drejt standarteve të BE-së, (ii) krijimin e kapaciteteve për një kontroll efektiv për ndihmën shtetërore dhe (iii) rritjen e efektivitetit në mbrojtjen e konsumatorëve (këto dy rekomandime për qeverinë), (iv) reduktimin e kriterëve për zgjedhjen e antarëve të Komisionit të Konkurrencës, (v) vazhdimin e pavarësisë së Autoritetit të Konkurrencës, (vi) përafrimin e kuadrit ligjor për njoftimin e përqëndrimeve, (vii) rritjen e ndërgjegjësimit publik për politikën anti-kartel dhe (viii) një politikë më atraktive për lehtësimin nga gjobat, (ix) luftën kundër karteleve në prokurimet publike në bashkëpunim me institucionet e ngarkuara me prokurimet publike dhe antikorrupsionin, (x) vazhdimin e forcimit të instrumentave për advokatinë e konkurrencës, (xi) rritjen e kulturës së konkurrencës te operatorët ekonomikë, (xii) përfshirjen e rregullores për vendimet me angazhime, (xiii) rritjen e ndërgjegjësimit publik për kërkesën e biznesit për zbatimin e ligjit të konkurrencës, (xiv) rritjen e kapaciteteve për inspektimet, (xv) ngritjen e funksionit të chief-economist, (xvi) ngritjen e një sistemi eficient për ezekutimin e gjobave të Autoritetit të Konkurrencës (rekomandim për qeverinë), (xvii) një sistem karriere dhe incentiva për stafin e Autoritetit të Konkurrencës, (xviii) vazhdimin e projekteve të asistencës teknike, (xix) trajnimin e gjyqtarëve dhe (xx) ngritjen e një biblioteke në Autoritetin e Konkurrencës.

Bashkëpunimi mes UNCTAD dhe Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës do të konkretizohet me fillimin e një projekti të asistencës teknike që fillon në vjeshtë të këtij viti, me synimin e zbatimit të rekomandimeve, ngritjen profesionale të stafit të Autoritetit dhe rritjen e ndërgjegjësimit të biznesit dhe institucioneve të tjera publike mbi rëndësinë e zbatimit të Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës në funksion të një ekonomie tregu funksionale.